thoshte miku i mirë, mirpo kjo vepër më bënte të dyshoj mi trimënin' e vërtetë.

Nuk i thonë trimëri të vesh të zesh vënt të fshehur e të keq dhe që andej të vrasësh armikun tënt, të cilit s'i jep rast që të të luftojë burrërisht. Prita, ose pusia si i thonë, është e dobët dhe trimat e vërtetë nuk ndjekin të këtilla mjete. Pritën në Mirditë s'e konsiderojnë si gjë të ndershme dhe admirojnë atë që thotë: "Unë jam Marku që ju dal ball për ball!" Edhe trimi i vërtetë flet me këtë mënyrë: "Prit se mrrina!" I dyti i përgjigjet: "Hajt se të pres." Bam, kërcet alltia dhe bie për dhê kush t'a ketë kësmet! Një tjatër burrë i thotë "hasmit" të tij.:

"Pse nuk dole fushë në fushë
Të puthshim hutat buz' nër buzë!"